

# Të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe ndikimi i tyre në politikat publike

## 1. HYRJE

Më 21 shtator 2012, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikoi rezultatet përfundimtare të regjistrimit të popullsisë. Regjistrimi i popullsisë në Kosovë u krye gjatë periudhës 1-15 prill 2011 dhe ky paraqet regjistrimin e parë pas 30 vitesh.

Instituti për Studime të Avancuara GAP ka analizuar të dhënat përfundimtare të publikuara nga ASK. Në këtë publikim, GAP analizon të dhënat e regjistrimit të popullsisë nga dy aspekte: saktësinë e të dhënave dhe ndikimin e tyre në politikat publike.

Në këtë raport do të përqendrohemi në këto fusha në të cilat pritet që rezultatet e regjistrimit të popullsisë të kenë ndikim në politikat e gjertanishme qeveritare:

- Numri i popullsisë sipas komunave dhe ndikimi i statistikave të reja në përcaktimin e grantit qeveritar për komunë, si dhe numrin e shërbyesve civil për çdo komunë;
- Personat mbi moshën 65 vjeçare kundrejt të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për përfituesit e pensionit të pleqërisë;
- Të dhënat për punëkërkesit kundrejt të dhënave të punëkërkesve në Qendrat Komunale për Punësim;
- Të dhënat për numrin e përgjithshëm të popullsisë kundrejt listave të votuesve; dhe
- Të dhënat e popullsisë kundrejt politikave qeveritare për minoritetet.

Përmes kësaj analize synojmë që përmes disa shembujve, të tregojmë ndikimin që të dhënat nga regjistrimi i popullsisë do të mund të kenë në bërjen e politikave publike.

## 2. TË DHËNAT E REJA NGA REGJISTRIMI I POPULLSISË DHE NDIKIMET NË NDARJEN E GRANTIT QEVERTAR PËR KOMUNA

Formula për ndarjen e grantit qeveritar për komuna bazohet në katër kriterë: numrin e popullsisë, numrin e popullsisë pakicë, nëse shumica e popullsisë përbëhet nga pakicat kombëtare dhe madhësia gjeografike.<sup>1</sup> Kalkulimet për numrin e popullsisë së përgjithshme për secilën komunë dhe numrin e popullsisë pakicë janë bazuar kryesisht në të dhëna të OSBE-së dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës, por të cilat kanë qenë të paverifikuara mirë. Pas procesit të decentralizimit dhe zgjedhjeve lokale të 2009, disa komuna janë tkurrur territorialisht dhe me numër të popullsisë, mirëpo grantet operative të Qeverisë për këto komuna nuk kanë ndryshuar. Ligji për financat e pushtetit lokal lë hapur mundësinë që pas të dhënave të regjistrimit të popullsisë, të dhënat e përdorura për ndarjen e grantit operativ për komuna të korrigojnë dhe në bazë të tyre të ndahet granti.<sup>2</sup>

Tabela 1: Dallimi në mes të dhënave të paraqitura në "Shtojcën I" të Ligjit për financat e pushtetit lokal për numrin e popullsisë së përgjithshme dhe minoriteteve në krahasim me të dhënat nga regjistrimi i popullsisë

Komuna	Numri i popullsisë sipas Ligjit për financat e pushtetit lokal	Nr. i popullsisë sipas regjistrimit të popullsisë	Diferenca	Nr i minoriteteve sipas Ligjit për financat e pushtetit lokal	Nr. i minoriteteve sipas regjistrimit të popullsisë	Difere nca
Deçan	40.400	40.019	- 381	294	550	+256
Gjakovë	115.000	94.556	- 20.444	6.013	6679	+666
Glllogoc	60.000	58.531	- 1.469	0	45	+45
Gjilan	100.348	90.178	- 10.170	4.058	2264	-1794
Dragash	35.000	33.997	- 1.003	12.935	13.559	+624
Istog	44.000	39.289	- 4.711	2.646	3.085	+439

<sup>1</sup>Neni 24, pika 4, Ligji nr.03/L-049 për financat e pushtetit lokal. Burimi: <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/T-Ligji%20p%C3%ABr%20financat%20e%20pushtetit%20lokal-shqip%20i%20lekturuar%2007.05.pdf>.

<sup>2</sup>Neni 35, pika 1, Ligji nr.03/L-049 për financat e pushtetit lokal. Burimi: <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/T-Ligji%20p%C3%ABr%20financat%20e%20pushtetit%20lokal-shqip%20i%20lekturuar%2007.05.pdf>.

<b>Kaçanik</b>	33.000	33.409	- 409	4	36	+32
<b>Klinë</b>	44.000	38.496	- 5.504	1.863	1241	-622
<b>Fushë K.</b>	33.682	34.827	+ 1.145	3.730	4511	+781
<b>Kamenicë</b>	49.581	36.085	- 13.196	4.670	1864	-2.806
<b>Mitrovicë<sup>3</sup></b>	90.000	71.909	- 18.091	0	2199	+2.199
<b>Leposaviq<sup>4</sup></b>	-	-	-	-	-	-
<b>Lipjan</b>	69.115	57.605	- 11.510	4.952	3112	-1.840
<b>Novobërdë</b>	9.899	6.729	- 3.170	2.785	3192	+407
<b>Obiliq</b>	26.000	21.519	- 4.481	3.360	1655	-1.705
<b>Rahovec</b>	63.000	56.208	- 6.792	1.953	944	-1009
<b>Pejë</b>	115.000	96.450	- 18.550	12.650	8.334	- 4316
<b>Podujevë</b>	117.000	88.499	- 28.501	735	849	+114
<b>Prishtinë</b>	388.561	198.897	- 189.664	4.961	4146	-815
<b>Prizren</b>	214.963	177.781	- 37.182	30.077	31.682	+1.605
<b>Skenderaj</b>	56.000	50.858	- 5.142	366	109	-257
<b>Shtime</b>	28.000	27.324	- 676	560	858	+298
<b>Shtërpcë</b>	11.000	6.949	- 4.051	3.438	3167	+271
<b>Suharekë</b>	80.000	59.722	- 20.278	471	575	+104
<b>Ferizaj</b>	111.000	108.610	- 2.390	3.367	4193	+826
<b>Viti</b>	46.458	46.987	+ 529	293	258	-35
<b>Vushtrri</b>	75.000	69.870	- 5.130	2.615	960	-1655
<b>Zhubin P.</b>	-	-	-	-	-	-
<b>Zveçan</b>	-	-	-	-	-	-
<b>Malishevë</b>	52.000	54.613	+ 2.613	28	54	+26
<b>Hani i E.</b>	10.000	9.403	- 597	0	44	+44
<b>Mamushë</b>	6.000	5.507	- 493	0	820	-
<b>Junik</b>	9.600	6.084	- 3.516	0	4	-
<b>Klllokoti</b>	4.542	2.556	- 1.986	1.205	763	-
<b>Graçanicë</b>	18.642	10.675	- 7.967	2.670	2517	-153
<b>Ranillug</b>	4.955	3.866	- 1.089	0	170	-
<b>Partesh</b>	5.217	1.787	- 3.430	0	0	0

Nga tabela e mësipërme shihet se dallimi më i madh në të dhënat e popullsisë paraqitet në komunat si: Prishtina (dallimi për 189.664 banorë), Prizreni (dallimi për 37.182), Podujeva (28.501), Gjakova (20.444), Suhareka (20.278), etj. Vetëm në tri komuna, rezultatet e regjistrimit të popullsisë kanë treguar se numri i popullsisë është më i madh se sa të dhënat e përdorura nga Ministri e Financave për të përlllogaritur ndarjen e granteve. Të gjitha komunat tjera kanë më pak popullsi se sa është përlllogaritur.

Regjistrimi nuk është bërë për tri komunat e veriut të Kosovës (Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan). Me qëllim të nxjerrjes së të dhënave se sa do të duhej të ishin grantet e përgjithshme për secilën komunë pas rezultateve të regjistrimit, për komunat e veriut të Kosovës kemi përlllogaritur numrin e popullsisë dhe numrin e

<sup>3</sup> Në regjistrimin e popullsisë si dhe gjatë ndarjes se granteve Mitrovica është specifikuar vetëm pjesa jugore e saj.

<sup>4</sup> Leposaviq, Mamushë, Zveçan, Shtërpcë, Graçanicë, Partesh, Ranillug.

komunitetit pakicë në bazë të mesatares së rritjes apo zvogëlimit të këtyre numrave në komunat tjera pakicë të Kosovës.<sup>5</sup> Ky supozim natyrisht se nuk do të jep të dhëna të sakta, por në mungesë të të dhënave të numrit të popullsisë për këto komuna kemi aplikuar këtë metodë më qëllim të ruajtjes së formulës që përdoret për llogaritjen e granteve të përgjithshme për komuna. Shuma totale që është ndarë si grante të përgjithshme për komunat e veriut për vitin 2011 ka qenë rreth 4 milion euro (rreth 3.6% e shumës totale të grantit të përgjithshëm për komunat e Kosovës).

Mungesa e të dhënave për këto tri komuna do të shkaktojë problem në alokimin e granteve të përgjithshme për komunat e Kosovës, pasi që kjo ndikon tek pjesëmarrja e përgjithshme e secilës komunë në totalin e grantit të përgjithshëm për një vit të caktuar. Sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, shuma e grantit të përgjithshëm është 10% e të hyrave totale të qeverisë qendrore që përjashton të hyrat nga shitja e pasurive, të hyrat e jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara dhe të hyrat nga huamarrja. Pas një shume fikse prej 140,000 euro që ndahet për çdo komunë minus 1 euro për kokë banori, pjesa tjetër alokohet në përpjestim me numrin e popullsisë (89%), numrin e popullsisë pakicë (3%), nëse shumica e popullsisë përbëhet nga pakica kombëtare (2%) dhe madhësia gjeografike (6%).

Tabela 2: Granti për komunat e Kosovës sipas të dhënave të gjertanishme (kolona 1), granti i modeluar pas të dhënave të ASK për regjistrimin e popullsisë (2) dhe diferenca në mes këtyre dyjave në përqindje (3) dhe sipas vlerës në euro (4)

Komunat	1 Granti i përgjithshëm sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal (në euro)	2 Granti i përgjithshëm pas regjistrimit (në euro)	3 Diferenca në përqindje	4 Diferenca në euro
Deçan	2.107.651	2.483.863	15%	+376.211,94
Dragash	2.309.923	2.109.601	-9%	(200.321,54)
Ferizaj	5.246.176	6.629.482	21%	1.383.305,55
Fushë K.	1.774.878	2.371.406	25%	596.528,42
Gjakovë	5.615.326	5.933.679	5%	318.353,42
Gjilan	4.837.680	5.470.308	12%	632.627,77
Drenas	2.878.599	3.531.997	18%	653.398,30
Graçanicë	1.374.193	1.431.084	4%	56.890,57
Han i E.	633.502	686.672	8%	53.169,55
Istog	2.395.202	2.415.593	+1%	20.391,12
Junik	607.304	492.549	-23%	(114,755,32)

<sup>5</sup> Është llogaritur mesatarja për komunat e Graçanicës, Kllokotit, Mamushës, Novobërdës, Ranillugut dhe Shtërpçës dhe proporcionalisht është aplikuar për tri komunat që nuk kanë qenë të përfshira në regjistrim.

<b>Kaçanik</b>	1.710.256	2.076.614	+18%	366.357,56
<b>Kamenicë</b>	2.628.796	2.318.469	-13%	(310.326,95)
<b>Klinë</b>	2.246.522	2.428.496	+7%	181.974,33
<b>Kllokot</b>	459.838	441.515	-4%	(18.323,31)
<b>Leposaviq</b>	1.695.738	1.200.563	-41%	(495.174,51)
<b>Lipjan</b>	3.470.269	3.624.123	+4%	153.853,61
<b>Malishevë</b>	2.604.566	3.305.512	+21%	700.945,64
<b>Mamushë</b>	526.850	852.210	+38%	325.359,52
<b>Mitrovicë</b>	5.894.989	4.409.158	-34%	(1.485.830,60)
<b>Novobërdë</b>	957.516	861.146	-11%	(96.370,29)
<b>Obiliq</b>	1.421.744	1.464.938	+3%	43.193,78
<b>Partesh</b>	445.793	376.152	-19%	(69.641,04)
<b>Pejë</b>	5.829.270	5.726.357	-2%	(102.913,08)
<b>Podujevë</b>	5.484.706	5.305.821	-3%	(178.884,57)
<b>Prishtinë</b>	17.137.525	11.856.275	-45%	(5.281.250,13)
<b>Prizren</b>	10.315.732	10.437.801	+1%	122.069,21
<b>Rahovec</b>	3.030.338	3.440.183	+12%	409.845,13
<b>Ranillugë</b>	494.957	642.813	+23%	147.855,67
<b>Shtërpçë</b>	1.025.591	907.802	-13%	(117.788,54)
<b>Shtime</b>	1.447.733	1.763.262	+18%	315.528,53
<b>Skenderaj</b>	2.827.994	3.090.652	+8%	262.658,32
<b>Suharekë</b>	3.756.559	3.626.162	-4%	(130.396,65)
<b>Viti</b>	2.360.435	2.873.542	+18%	513.107,01
<b>Vushtri</b>	4.192.527	4.232.187	+1%	39.659,61
<b>Zhubin P.</b>	1.324.350	1.001.837	-32%	(322.513,29)
<b>Zveçan</b>	1.138.596	1.043.641	-9%	(94.954,65)
<b>Mitrovica V.</b>		1.346.160		
	114.209.624	114.209.624		

Nga tabela e mësipërme, shihet se më së shumti pritet të dëmtohet Komuna e Prishtinës e cila pritet të ketë 5.2 milion euro më pak grant qeveritar nga viti i ardhshëm. Komunat tjera nuk do të pësojnë rënie të mëdha të grantit qeveritar. Pas Prishtinës renditen: Mitrovica, Kamenica, Suhareka, Shtërpca, Dragashi, etj. Kurse komuna e cila do të përfitojë rritje më të madhe të grantit qeveritar pas të dhënave të regjistrimit të popullsisë është Komuna e Ferizajt me 1.3 milion euro grant shtesë. Pas Ferizajt grante më të mëdha do të përfitojnë edhe komunat: Drenas, Gjilan, Kaçanik, Lipjan, etj.

### 3. TË DHËNAT E REGJISTRIMIT TË POPULLSISË DHE NDIKIMET NË PUNËSIM NË ADMINISTRATAT LOKALE

Të dhënat e ASK për numrin e popullsisë sipas komunave obligojnë Qeverinë e Kosovës dhe komunat që të rishikojnë numrin e të punësuarve në administratat lokale. Në vitin 2008, Qeveria e Kosovës kishte themeluar një Grup punues ndërministror për kriteret e madhësisë së administratës komunale. Pas një pune disa mujore, ky Grup ndërministror kishte dal me një konstatim për numrin e shërbyesve civil që duhet të ketë çdo komunë. Qeveria e Kosovës raportin e Grupit ndërministror e ka aprovuar më 3 dhjetor 2008, vendimi 10/46.<sup>6</sup> Vendimi i Qeverisë së Kosovës vendos dy kriteret mbi madhësinë e administratave lokale:

1. **Kriteri bazë:** të gjitha komunat pa marrë parasysh madhësinë e tyre, bazuar nga obligimet që dalin nga legjislacioni për funksionimin e tyre i'u nevojitet stafi në kufirin minimal prej 55;
2. **Kriteri Suplementar:**
  - Komunat e Republikës së Kosovës që kanë mbi 100.000 banorë, duhet që një nëpunës administrativ të shërbejë për 620 qytetarë.
  - Komunat e tjera që kanë nën 100.000 banorë, duhet që një nëpunës administrativ të shërbejë për 780 qytetarë.

Sipas kësaj formule, Instituti GAP ka krahasuar të dhënat më të fundit të regjistrimit të popullsisë për komuna me numrin e të punësuarve në administratat komunale. Në bazë të këtij krahasimi, del se mbi 70% e komunave kanë mbingarkesë të administratave lokale me shërbyes civil. Komunat me më së shumti staf të tepërt janë Prishtina me 408 të punësuar më shumë se sa që e parasheh vendimi qeveritar, Gjilani me 221, Mitrovica me 229, Gjakova 193, Kamenica 154, etj. Kurse komunat që duhet të punësojnë staf janë kryesisht komunat e themeluara pas zgjedhjeve lokale të 2009, të cilat, në bazë të kriterit bazë të vendimit të Qeverisë, duhet të kenë nga 55 të punësuar secila.

<sup>6</sup> Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/46 i datës 03.12.2008. Burimi: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_46-te\\_te\\_Qeverise\\_2008.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_46-te_te_Qeverise_2008.pdf)



Tabela 3: Madhësia e administratave lokale në përpjesëtim me numrin e popullsisë dhe vendimin e Qeverisë 10/46 të 3 dhjetorit 2008.

Komuna	Nr. i popullsisë pas regjist rimit	Nr i të punësuarve në administratat Komunale sipas viteve*				Nr. i të punësuarve që duhet të ketë çdo komunë sipas vendimit të Qeverisë	Diferenca në vitin 2012 +/-
		2008	2009	2011	2012		
Deçan	40.019	108	104	120	123	55	+ 68
Gjakovë	94.556	265	255	313	314	121	+ 193
Drenas	58.531	131	121	125	137	75	+ 62
Gjilan	90.178	269	258	339	336	116	+220
Dragash	33.997	101	120	141	140	55	+ 85
Istog	39.289	141	140	158	158	55	+ 103
Kaçanik	33.409	105	107	127	127	55	+ 72
Klinë	38.496	126	121	136	134	55	+ 79
Fushë K.	34.827	134	139	142	143	55	+ 88
Kamenicë	36.085	184	177	206	209	55	+ 154
Mitrovicë	71.909	253	248	316	321	92	+ 229
Leposaviq**	-	97	97	129	129	-	-
Lipjan	57.605	186	184	204	186	74	+ 112
Novobërdë	6.729	30	44	61	61	55	+ 6
Obiliq	21.519	87	87	85	85	55	+ 30
Rahovec	56.208	155	148	171	177	72	+ 106
Pejë	96.450	291	266	293	336	123	+212
Podujevë	88.499	228	233	252	258	113	+ 145
Prishtinë	198.897	699	651	705	728	320	+ 408
Prizren	177.781	295	286	331	341	287	+ 54
Skenderaj	50.858	196	192	200	209	66	+ 143
Shtime	27.324	85	66	75	91	55	+ 36
Shtërpcë	6.949	55	60	69	84	55	+ 29
Suharekë	59.722	147	147	155	155	77	+ 78
Ferizaj	108.610	233	231	295	289	175	+ 114
Viti	46.987	160	168	176	182	60	+ 122
Vushtrri	69.870	217	209	227	216	90	+126
Zhubin P.**	-	83	83	223	223	-	-
Zveçan**	-	30	30	56	56	-	-
Malishevë	54.613	125	125	146	155	70	+ 85
Hani i E.	9.403	20	32	49	50	55	- 5
Mamushë	5.507	17	31	38	44	55	-11
Junik	6.084	11	27	52	54	55	-1
Klllokoti	2.556	-	-	45	45	55	-10
Graçanicë	10.675	-	-	53	52	55	-3
Ranillug	3.866	-	-	51	50	55	-5
Partesh	1.787	-	-	30	42	55	-13
<b>Totali</b>					<b>6032<sup>7</sup></b>	<b>2921</b>	<b>3111</b>

\*Të dhëna të marra nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil, MAP.

\*\*Të dhëna jo të plota për komunat Leposaviq, Zvecan, Zubin Potok.

<sup>7</sup> Në totalin prej 6032 nëpunësve nuk janë përllogaritur nëpunësit civil që figurojnë në listat e të punësuarve në Leposavic, Zhubin Potok dhe Zvecan.

Sipas kësaj formule dhe të dhënave të regjistrimit të popullsisë, del se në total në nivelin lokal janë 3.111 nëpunës civil më tepër se që e lejon vendimi i Qeverisë nr.10/46 i 3 dhjetorit 2008. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, paga mesatare në Kosovë më 2011 ishte 368 euro.<sup>8</sup> Sipas kësaj del se për 3.111 më tepër të punësuar, buxheti i Kosovës shpenzon mbi 1.1 milion euro në muaj apo 13.7 milion euro në vit.

Disa nga komunat e Kosovës, përkundër zvogëlimit të numrit të popullsisë dhe territorit, pas procesit të decentralizimit, kanë vazhduar që të rrisin administratat e tyre lokale. Një rast të tillë paraqet Gjilani, nga i cili është ndarë një pjesë e territorit dhe popullsisë, për të krijuar komunën e re të Parteshit dhe për të zgjeruar komunën e re të Novobërdës. Përkundër kësaj, administrata lokale e Gjilanit ka shkuar duke u rritur dukshëm. Njëjtë është edhe rasti i komunës së Kamenicës, Lipjanit dhe Prishtinës.

Në vendimin 10/46 të Qeverisë së Kosovës thuhet se brenda një periudhe 20 mujore nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit, Komunat duhet të përshtatin numrin e të punësuarve në administratat komunale me këtë vendim. Pasi që në kohën e marrjes së vendimit të Qeverisë (dhjetor 2008) nuk kanë ekzistuar të dhëna të bazuara për numrin e popullsisë nëpër komuna, Qeveria e Kosovës duhet të obligojë komunat që në 20 muajt në vazhdim të ndërmarrin masa për zvogëlimin e numrit të shërbyesve civil në administratat e tyre lokale. Zvogëlimi i numrit të shërbyesve civil është edhe një nga kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).<sup>9</sup>

#### 4. TË DHËNAT E REGJISTRIMIT TË POPULLSISË KUNDREJT LISTËS SË VOTUESVE

Ajo e cila ka hasur në shumë reagime dhe është diskutuar gjerë në publik janë të dhënat e përafërta në mes të listës së votuesve për komuna dhe numrit total të popullsisë. Në disa raste, numri i votuesve për komunë e tejkalon numrin e banorëve në total (kjo haset në komunat si Gjakovë, Dragash, Istog, Klinë, Novobërdë, Shtërpçë,

<sup>8</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Kosova në shifra 2011. Prill 2012. Fq. 10.

<sup>9</sup> International Monetary Fund. Republic of Kosovo: First Review Under the Stand-By Arrangement, and Request for Modification of Performance Criteria – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion. Burimi:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2012/cr12180.pdf>



Graçanicë, Kllokot, Partesh, Ranillug). Madje në disa komuna (Shtëprcë, Partesh), lista e votuesve përmban përgjysmë më shumë emra se sa lista e popullsisë totale të asaj komune.

Deri tek ky dallim në shifra ka ardhur për shkak të dallimit në metodologjinë e krijimit të listave nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) dhe ASK. Lista e votuesve hartohet nga regjistri civil. Regjistri civil është në gjendje jo të mirë, ngase në të figurojnë edhe personat e vdekur, personat të cilët nuk janë të regjistruar në komunat ku jetojnë, etj. Regjistri civil përpilohet me qëllim të lëshimit të dokumenteve personale dhe përveç banorëve të Kosovës në këtë regjistrë figurojnë edhe qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë vendit. Përderisa sipas metodologjisë për regjistrimin e popullsisë, qytetarët kosovar me banim jashtë vendit nuk janë regjistruar.

Tabela 4: Krahasimi i të dhënave nga regjistrimi i popullsisë për komuna dhe të dhënave të KQZ për votues me të drejtë vote në çdo komunë

	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)
Komuna <sup>10</sup>	Votues të regjistruar	Numri i popullsisë	Numri i popullsisë mbi 18 vjet (votues)	Diferenca në mes të votuesve dhe popullsisë mbi 18 vjet në regjistrin e ASK (4)=(3)-(1)	Kolona (4) e shprehur në %
Deçan	37.244	40.019	25.367	11.877	31.89%
Gjakovë	97.215	94.556	58.803	38.412	39.51%
Drenas	46.657	58.531	35.350	11.307	24.23%
Gjilan	87.387	90.178	56.890	30.497	34.90%
Dragash	36.658	33.997	22.292	14.366	39.19%
Istog	40.778	39.289	24.329	16.449	40.34%
Kaçanik	30.308	33.409	20.433	9.875	32.58%
Klinë	38.705	38.496	22.833	15.872	41.01%
Fushë K.	28.105	34.827	21.624	6.481	23.06%
Kamenicë	35.381	36.085	23.433	11.948	33.77%
Mitrovicë <sup>11</sup>	74.450	71.909	44.817	29.633	39.80%
Lipjan	50.374	57.605	34.706	15.668	31.10%
Novobërdë	7.936	6.729	4.491	3.445	43.41%
Obiliq	21.313	21.549	13.132	8.181	38.39%
Rahovec	49.321	56.208	33.874	15.447	31.32%
Pejë	93.721	96.450	62.062	31.659	33.78%
Podujevë	75.636	88.499	53.192	22.444	29.67%

<sup>10</sup>Duke mos përfshirë tri komunat veriore Leposavic, Zubin Potok, Zvečan, në të cilat nuk është mbajtur regjistrimi i popullsisë.

<sup>11</sup>Mitrovica e Veriut nuk është përfshirë në regjistrimin e popullsisë, ndërsa është e përfshirë në listën e votuesve. Në ndarjen e granteve, Qeveria e Kosovës llogarit që popullata e Mitrovicës së Veriut është 20,000. Në bazë të proporcionit mesatar të të gjithë Kosovës në mes të numrit total të popullatës dhe popullatës mbi 18 vjeç, atëherë nxjerrim numrin 12,384 të jetë numri i votuesve të Mitrovicës së Veriut. Rrjedhimisht, këtë numër e zbrisim nga numri i votuesve të Mitrovicës që numrat të përshtaten me komunën përkatëse.

Prishtinë	161.236	198.897	130.067	31.169	19.33%
Prizren	144.579	177.781	110.636	33.943	23.48%
Skenderaj	49.320	50.858	30.584	18.736	37.99%
Shtime	22.313	27.324	15.772	6.541	29.31%
Shtërpçë	12.604	6.949	4.638	7.966	63.20%
Suharekë	57.617	59.722	35.847	21.770	37.78%
Ferizaj	91.876	108.610	66.059	25.817	28.10%
Viti	42.882	46.987	27.689	15.193	35.43%
Vushtrri	63.300	69.870	43.151	20.149	31.83%
Malishevë	44.089	54.613	29.652	14.437	32.75%
Junik	5.191	6.084	3.831	1.360	26.20%
Mamushë	3.112	5.507	3.159	-47	-1.51%
Hani i E.	7.943	9.403	5.725	2.218	27.92%
Gracanicë	16.825	10.675	7.149	9.676	57.51%
Ranillug	4.929	3.866	2.903	2.026	41.10%
Partesh	3.694	1.787	1.250	2.444	66.16%
Klllokot	2.785	2.556	1.576	1.209	43.41%
<b>Total</b>	<b>1.585.484</b>	<b>1.739.825</b>	<b>1.077.316</b>	<b>508.168</b>	<b>32.05%</b>

Diferenca në mes të listës së votuesve dhe numrit të popullsisë mbi moshën 18 vjeçare rezulton të jetë 508.168. Ky numër është pothuajse gjysma e popullsisë votuese sipas ASK dhe afërsisht një e treta e listës së votuesve. Kjo përqindje varion në nivel komunal, ku komunat me shumicë serbe kanë tendencë që të kenë përqindje më të larta të votuesve kundrejt popullsisë. Ndërsa kjo diferencë përbën numrin e njerëzve të regjistruar në regjistrin civil të cilët nuk jetojnë në Kosovë dhe numrin e të vdekurve të cilët nuk janë pastruar nga lista e votuesve.<sup>12</sup>

Lista e votuesve ka paraqitur një nga problemet më të mëdha në mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Numri i madh i të vdekurve dhe participimi në nivel shumë të ulët në zgjedhje i diasporës kanë paraqitur hapësirë të madhe për manipulim të zgjedhjeve. Kjo për shkak se votat mund të hedhën në emër të këtyre personave nga manipuluesit e zgjedhjeve. Gjithashtu ky numër i ndryshon rrënjësisht statistikën e participimit të votuesve në zgjedhje, një indikator statistikor shumë i rëndësishëm.

Mirëpo përkundër diferencave të mëdha, sipas KQZ, ky institucion do të vazhdojë të përdor të dhënat e tij për listat e votuesve, duke i

<sup>12</sup> Sipas Statistikave të Vdekjeve të publikuara nga ASK, prej vitit 2002 deri në vitin 2011 kanë vdekur 77.843 persona (pa përfshirë foshnjat dhe duke shtuar një mesatare për vitet 2000/2001). Ndërsa përqindja e raportimit të vdekjeve llogaritet të jetë rreth 80%. Nga këto statistika mund të llogarisim që në Kosovë prej vitit 2000 kanë vdekur por nuk janë larguar nga lista e votuesve rreth 15.568 persona. Kjo do të na jepte edhe numrin e diasporës se regjistruar i cili është 492.600. Mirëpo numri prej 492.600 nuk është numri total i diasporës, këtij numri duhet ti shtohet edhe popullsia nën 18 vjeç në diasporë dhe personat në diasporë të cilët nuk janë të regjistruar në regjistrin civil të Kosovës (pra 492.600 + personat nën 18 vjet + personat e pa dokumente të Kosovës).

konsideruar ato si më të sakta se të dhënat e ASK për regjistrimin e popullsisë.<sup>13</sup>

## 5. TË DHËNAT E ASK DHE INSTITUCIONEVE PËR NUMRIN E PUNËKËRKUESVE DHE PENSIONISTËVE

Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë dallojnë edhe nga të dhënat me të cilat punon Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Këto dallime vërehen së paku në tri aspekte: punëkërkuesit e regjistruar, numri i pensionistëve dhe personat në skemat sociale.

### a. Shkalla e papunësisë

Të dhënat e fundit nga regjistrimi i popullsisë tregojnë se nga 1.252.248 banorë të Kosovës që janë mbi 15 vjeç, 508.100 e tyre përbëjnë fuqinë punëtore në Kosovë. Nga ta, 280.454 persona janë të punësuar kurse 227.464 persona të tjerë konsiderohen të pa punë. Por, edhe numri i të punësuarve edhe numri i të pa punëve që ofron ASK nuk përputhet me të dhënat që ofrojnë institucionet tjera. Përderisa ASK pohon se në Kosovë janë gjithsej 227.464 persona të pa punë, të dhënat e MPMS thonë se numri i të papunëve është 325.261.<sup>14</sup>

Edhe numri i të punësuarve që del nga regjistrimi i popullsisë dallon nga numri i të punësuarve që ofron Trusti. Sipas ASK, në Kosovë janë të punësuar 280.454 persona, ndërkaq të dhënat nga Trusti tregojnë se deri në fund të shtatorit 2012 numri i kontribuuesve aktiv në Trust ka qenë 251.009. Kontribuues aktiv konsiderohen të gjithë ata të punësuar që kanë kontribuar në Trust brenda një viti, pavarësisht shumës së kontributit. Kjo mospërputhje e të dhënave tregon edhe nivelin e lartë të ekonomisë joformale në Kosovë.

<sup>13</sup> Prononcim i Kryetares së KQZ Valdete Daka për Radio Televizionin e Kosovës, 23 shtator 2012. Burimi: [http://www.rtklive.com/neë/?cid=1&neësId=65244&mf36-wAz4611\\*](http://www.rtklive.com/neë/?cid=1&neësId=65244&mf36-wAz4611*) (hapur së fundmi më 25 shtator 2010), <http://www.telegrafi.com/lajme/gjakova-me-shume-votues-se-banore-2-25187.html> (hapur së fundmi më 25 shtator 2010).

<sup>14</sup> Puna dhe Punësimi, Raporti Vjetor 2011, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Social <https://mpms.rks.gov.net/Portals/0/Librat/2011%20Raporti%20Vjetor%20Puna%20dhe%20Punesimi.pdf>

## b. Pensionet e pleqërisë

Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë po ashtu nxjerrin një shifër tjetër të numrit të pensionistëve në Kosovë, e cila dallon nga të dhënat që ofron MPMS. Sipas ASK, në Kosovë janë 112.020 persona që përfitojnë nga pensioni, prej të cilëve 84.694 persona janë mbi 65 vjeç. Shifrat nga MPMS për numrin e pensionistëve dallojnë nga ato të ASK. Sipas MPMS, në skemën e pensioneve bazike - të pleqërisë në muajin dhjetor 2011 kanë qenë të përfshirë 107.145 pensionistë.<sup>15</sup> Në skemën e pensioneve, po në dhjetor 2011, në listë të shfrytëzuesve kanë qenë 32.415 pensionistë. Nga skema për persona me aftësi të kufizuar, pensionin e shfrytëzojnë 18.594 persona. Pensionet e parakohshme "Trepça" aktualisht i marrin 3.833 ish-minatorë, kurse pensionin për ish-pjesëtarët e TMK-së, aktualisht e shfrytëzojnë 655 persona. Në total përfitues të pensioneve në Kosovë sipas MPMS deri në fund të vitit 2011 dalin të jenë 162.642 persona, që dallon dukshëm nga shifra prej 112.020 pensionistëve që ofron ASK.

## c. Përfituesit e ndihmave sociale

MPMS përveç pensionistëve menaxhon edhe skemën për ndihma sociale. Ka mospërputhje në mes të të dhënave që ofron ASK dhe atyre që ofron MPMS. Sipas ASK, nga ndihma sociale përfitojnë gjithsej 84.683 persona, kurse sipas MPMS në dhjetor 2011 numri i familjeve shfrytëzuese të ndihmave sociale ka qenë 34.867 familje me gjithsejtë 151.767 anëtarë të familjes.

Tabela 5: Dallimi në mes të dhënave të ASK kundrejt regjistrave të MPMS dhe Trustit

	ASK	MPMS	Trusti	Diferenca
<b>Të papunë</b>	227.464	325.261	-	<b>97.797</b>
<b>Të punësuar</b>	280.454	-	251.009	<b>118.621</b>
<b>Pensionistë</b>	112.02	162.642	-	<b>50.622</b>
<b>Përfitues të ndihmave sociale</b>	84.683	151.767	-	<b>67.084</b>

<sup>15</sup> Raporti për Aktivitetet e MPMS-së për vitin 2011 [http://mpms.rks.gov.net/Portals/0/Librat/Broshura\\_al\\_2011.pdf](http://mpms.rks.gov.net/Portals/0/Librat/Broshura_al_2011.pdf)

#### d. Zbatimi i Ligjit të punës

Të dhënat e ASK për të punësuarit japin një të dhënë shqetësuese sa i përket zbatueshmërisë së Ligjit të Punës. Sipas ASK, nga 280.454 të punësuarit në Kosovë, 54.110 punonjës kanë deklaruar se punojnë mbi 40 orë në javë ose, thënë ndryshe, 19.2% e të punësuarve kanë deklaruar se punojnë në kushte të cilat janë në kundërshtim me Ligjin e Punës. Sipas Ligjit të Punës, orari i plotë i punës zgjat 40 orë në javë.<sup>16</sup> Kjo e dhënë konfirmon për herë të parë me të dhëna të vërtetuara se Ligji i Punës është duke hasur në vështirësi zbatimi. Kjo e dhënë duhet t'i shërbejë Inspektoratit të Punës dhe MPMS në përgjithësi, që të rrisin aktivitetet në mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së Ligjit të Punës.

Mos përputhja e shifrave që ofron ASK nga ato që ofron MPMS rreth numrit të të pa punëve, numrit të pensionistëve në Kosovë si dhe numrit të përfituesve të ndihmës sociale, ngre dilemën se në cilat të dhëna duhet të bazohen politikat sociale në të ardhmen. Ndarja e buxhetit të shtetit për pensionistët dhe për përfituesit e ndihmave sociale deri më tani është bazuar në të dhënat që ka ofruar MPMS, të dhëna që dallojnë dukshëm nga ato të ASK. Nëse merren për bazë të dhënat e ASK, buxheti i ardhshëm për kategorinë e pensionistëve dhe përfituesve të ndihmave sociale do të jetë dukshëm më i vogël.

## 6. TË DHËNAT MBI PËRQINDJEN E KOMUNITETEVE MINORITARE DHE 6. 6. POLITIKA QEVERITARE E VENDEVE TË REZERVUARA

Në bazë të përlogaritjeve të bëra para regjistrimit të popullsisë, është konsideruar se në Kosovë shqiptarët përbëjnë 92% të popullsisë së përgjithshme, serbët 5.3%, romët 1.1%, turqit 0.4%, të tjerë 1.2%.<sup>17</sup> Në bazë të këtyre të dhënave, institucionet ndërkombëtare dhe ato vendore kanë përpiluar formulën mbi përfaqësimin e komuniteteve në institucionet e Kosovës në bazë të vendeve të rezervuara, fillimisht me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (2000), pastaj edhe me Pakon e Ahtisarit (2007) dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës (2008).

<sup>16</sup>Neni 20 pika 2 e Ligjit nr.03/L-212 i Punës. Burimi: [http://gazetazyrtare.rks.gov.net/Documents/Ligji%20i%20Punes%20\(shqip\).pdf](http://gazetazyrtare.rks.gov.net/Documents/Ligji%20i%20Punes%20(shqip).pdf)

<sup>17</sup> Këto të dhëna janë vlerësimi ASK për vitin 2006. Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës. Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës 1948-2006. Shkurt 2008.

Sa i përket ndarjes së vendeve në Kuvendin e Kosovës, komuniteti serb në Kosovë dhe komunitetet tjera që nuk janë shumicë në Kosovë do të kenë 20 ulëse të rezervuara në Kuvend në dy mandatet e para zgjedhore pas miratimit të Kushtetutës, 10 prej të cilave i takojnë komunitetit serb. Pas përfundimit të dy mandateve të para zgjedhore pas miratimit të Kushtetutës, komuniteti serb dhe komunitetet tjera do të bëjnë përpjekje që këto ulëse t'i fitojnë përmes zgjedhjeve, por, nëse numri i vendeve të fituara në Kuvend është më i vogël se sa vendet e garantuara gjatë dy mandateve të para pas miratimit të Kushtetutës, edhe komuniteti serb edhe komunitetet tjera jo shumicë në Kosovë do të kenë numrin e njëjtë të vendeve (20) sikur gjatë kohës së dy mandateve të para pas miratimit të Kushtetutës. Përveç komunitetit serb që ka 10 ulëse të rezervuara në Kuvend, është komuniteti boshnjak me 3 ulëse të rezervuara.

Sa i përket përfaqësimit në Qeveri të komunitetit serb dhe komuniteteve tjera që nuk janë shumicë në Kosovë, pikat 3 dhe 4 të nenit 96 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thonë se “në Qeveri do të jenë së paku një Ministër nga komuniteti serb dhe një Ministër nga komunitetet tjera jo-shumicë në Kosovë [...]”.<sup>18</sup>Në këtë nen përcaktohet emërimi edhe i një Ministri që përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë. E njëjta logjikë ndjeket edhe te përcaktimi i numrit të zëvendësministrave ku dy zëvendësministra janë nga komuniteti serb, dhe dy të tjerë nga komunitetet tjera jo shumicë në Kosovë, po ashtu e njëjta vlen edhe për zëvendësministra nëse Qeveria përbëhet nga më shumë se 12 ministri.

Të dhënat e fundit të popullsisë renditin komunitetin boshnjak si komunitetin më të madh minoritar në Kosovë me 1.66%, pas tij vijonë turqit me 1.05%, komuniteti RAE 2.06%, goran 0.58%, dhe komunitetet tjera 0.13%. Por, nëse llogarisim se në tri komunat veriore jetojnë 41.000 serb, atëherë së bashku me numrin e serbëve të regjistruar në pjesën tjetër të territorit, përbërja e komunitetit serb përbën 3.55% të popullsisë totale të Kosovës.

Edhe pse asnjëherë që nga themelimi i institucioneve kosovare numri i ulëseve të rezervuara në Kuvend dhe Qeveri nuk është ndërlidhur me numrin e popullsisë që këto komunitete realisht përfaqësojnë, të dhënat nga regjistrimi i popullsisë tregojnë se komuniteti serb është privilegjuar shumë më shumë se sa komunitetet tjera pakicë.

---

<sup>18</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 96, pika 3 dhe 4.



## 7. PËRFUNDIM

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është pritur për shumë vite dhe ka qenë shumë i domosdoshëm për shumë arsye, ndër to edhe për hartimin e drejtë të politikave publike. Përkundër përgatitjeve të gjata, përkushtimit të madh të institucioneve qeveritare, Agjencisë së Statistikave të Kosovës, dhe donatorëve ndërkombëtar, procesi i regjistrimit të popullsisë është përcjell me shumë parregullsi, të cilat janë elaboruar në shumë shkrime dhe analiza, andaj nuk janë objekt i trajtimit të kësaj analize.

Duke analizuar të dhënat e publikuara nga regjistrimi i popullsisë, Instituti për Studime të Avancuara GAP ka analizuar disa aspekte në të cilat të dhënat e ASK mund dhe duhet të ndryshojnë hartimin e politikave publike, si dhe ka krahasuar të dhënat e ASK me të dhënat të cilat janë duke u përdorur nga institucionet qendrore.

Pas kësaj analize rezulton se granti qeveritar për komuna nuk do të pësojë ndryshime të mëdha, përveç në komunën e Prishtinës e cila pritet të humb më së shumti nga shuma e grantit qeveritar që i ndahet komunave për çdo vit, kurse përfituesi më i madh i grantit qeveritar do të jetë Ferizaj.

Të dhënat e popullsisë për komuna i hapin rrugë zbatimit përfundimtar të vendimit të Qeverisë së Kosovës (3 dhjetor 2008) për kriteret e përcaktimit të madhësisë së administratës lokale. Sipas analizës së GAP, 70% e komunave të Kosovës janë të mbingarkuara me staf, nëse krahasohet numri i shërbyesve civil me numrin e popullsisë. Në total, administrata lokale në 37 komuna të Kosovës ka 3.111 shërbyes civil të punësuar më shumë se sa që e lejon vendimi i Qeverisë nr.10/46 i 3 dhjetorit 2008. Ky mbingarkim i administratës me staf civil i kushton buxhetit të Kosovës 1.1 milion euro në muaj apo 13.7 milion euro në vit.

Po ashtu, ajo çfarë ka krijuar konfuzion në publik nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë është edhe mos përputhja e të dhënave të ASK dhe listës së votuesve nëpër komuna. Ajo çfarë ka ndikuar në këtë mos përputhje të të dhënave është dallimi në metodologji të të dhënave në mes të ASK dhe KQZ. Përderisa KQZ në listat e votuesve përfshin edhe qytetarët e Kosovës në diasporë, ASK e ka përjashtuar këtë kategori nga regjistrimi. Si rrjedhojë, listat e votuesve përmbajnë më shumë emra se sa të dhënat e ASK.

Mos përputhje të të dhënave vërehen edhe në të dhënat sociale: ato të papunësisë, pensionistëve dhe rasteve sociale. Përderisa MPMS ka një listë të detajuar të përfituesve të ndihmave sociale, pensioneve dhe të papunëve të regjistruar, të dhënat e ASK japin shifra dukshëm më të ulëta se sa ato me të cilat punon MPMS dhe në bazë të të cilave buxheti i Kosovës ndan mbi 300 milion euro në vit. Korrigjimi i këtyre të dhënave do të ndikojë në politika më të drejta sociale.

Sa i përket përbërjes etnike të popullsisë, të dhënat e ASK vënë në pah defektet e një politike mbi dhjetë vjeçare në Kosovë: parimin e vendeve të rezervuara për komunitetet pakicë. Nëse shikohet politika e vendeve të rezervuara për komunitete, e vendosur së pari me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, pastaj me Pakon e Ahtisarit dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, vërehet se komuniteti serb është privilegjur padrejtësisht shumë më shumë se sa komunitetet tjera. Përderisa komuniteti serb përbën 3.55% të popullsisë së Kosovës dhe kjo përqindje nuk dallon shumë nga përqindja e komuniteteve tjera, komuniteti serb ka shumë herë më shumë privilegje në Qeveri, Kuvend dhe institucione tjera në krahasim me komunitetet tjera. Ndarja e vendeve të rezervuara për komunitetet pakicë, asnjëherë nuk është ndërlidhur me përqindjen e popullsisë etnike që ato përbëjnë në Kosovë.

Këta shembuj tregojnë se të dhënat nga regjistrimi i popullsisë kanë mbushur një boshllëk për statistika në Kosovë, megjithatë, këto të dhëna janë të luhatshme dhe nuk paraqesin të dhëna të besueshme në të cilat mund të bazohen politikat shtetërore buxhetore, sociale, administrative, etj.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.